

**Vendim nr. 76 datë 29.10.2024**

**(V-76/24)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.10.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 4 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **FATMA HOXHA, ARLIND HOXHA, ENDRI HOXHA**

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË, MYFTINIA DURREËS**, përfaqësuar nga kryetar Bujar Spahiu.

**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE DURREËS**, në mungesë.

**AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE**, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2013-661) 350, datë 07.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 204/10-2015-506, datë 04.03.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-3019, datë 13.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Myftinia Durrës (*Komuniteti Mysliman*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës (*ASHK*) dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit Fatma Hoxha, Arlind Hoxha dhe Endri Hoxha (*kërkuësit*), janë respektivisht bashkëshortja dhe fëmijët e shtetasit K.H., njëherazi edhe trashëgimtarët e tij. Çështja lidhet me një pronë, të ndodhur në lagjen nr. 6 “Rruga e Dëshmorëve”, Durrës, për të cilën, me akt-njoftuninë nr. 56, datë 10.06.1955, Gjykata Popullore e Rrethit Durrës ka vërtetuar faktin juridik të pronësisë së saj në favor të shtetasit A.H., stërgjyshi nga babai i kërkuësve Arlind dhe Endri Hoxha. Prona, sipas këtij vendimi, është një truall me sipërfaqe 1310 m<sup>2</sup>, me kufij të përcaktuar, si dhe dy ndërtesa të ngritura mbi të rreth 20 vjet përpara, ku njëra ishte 2-katëshe, me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup> dhe oborr 960 m<sup>2</sup>, ndërsa tjetra 1-katëshe dhe bashkë me oborrin zinte një sipërfaqe prej 230 m<sup>2</sup>. Vendimi gjyqësor në fjalë është regjistruar në regjistrat hipotekarë të kohës në favor trashëgimtarëve të A.H., dy nga të cilët në vijim e dhuruan pjesën e tyre në favor të bashkëpronarëve të tjerë, ndërsa këta të fundit, sipas aktit të pjesëtimit vullnetar të datës 10.10.1969, kanë pjesëtuar midis tyre ndërtesat, ku tre nga bashkëpronarët (ndër ta edhe gjyshi i kërkuësve Arlind dhe Endri Hoxha) pjesët e tyre takuese i kanë marrë në ndërtesën 2-katëshe, ndërsa bashkëpronarit tjetër i ka kaluar pronësia mbi ndërtesën 1-katëshe. Në aktin e pjesëtimit janë përcaktuar edhe kufijtë e pronave, ku prona e parë në veri kufizohej me “Rrugën e Dëshmorëve”, ndërsa në jug me pronën e dytë, kurse kjo e fundit në jug kufizohej me lulishten “1 Maji”.

2. Në vitin 2006 trashëgimtarët e A.H. i janë drejtuar Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRKKP*), Durrës për njohjen e pronësisë për truallin me sipërfaqe 960 m<sup>2</sup>, mbështetur në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*). Me vendimin nr. 39, datë 25.05.2007, ZRKKP-ja, Durrës ka

---

Vendim i Gjykatës Kushtetuese

Kërkuës: Fatma Hoxha, Arlind Hoxha dhe Endri Hoxha

Faqe 2

vendosur mosshqyrtimin e kërkesës për shkak se prona e pretenduar tek ish-lulishte “1 Maji” ishte trajtuar më parë, duke iu njohur dhe kthyer Komunitetit Mysliman (sipërfaqja 4600 m<sup>2</sup>) me vendimin nr. 205/1, datë 06.06.1997 (vendimi nr. 205/1/1997) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Durrës. Mbi ankimin e paraqitur, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 240, datë 07.09.2007 (vendimi nr. 240/2007), pasi ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të vendimit të ZRKKP-së, Durrës, ka shqyrtuar në themel çështjen, duke vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për subjektin A.H. (trashëgimtarët e tij) për truallin me sipërfaqe 960 m<sup>2</sup>. Sipas AKKP-së, pretendimi për pronën mbështetej në një vendim gjyqësor për vërtetim fakti i vitit 1955, ndërkohë që ajo pronë, bazuar në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga Komuniteti Mysliman, i është njohur dhe kthyer këtij të fundit me vendimin nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës.

3. Ndërkohë, të paktën prej vitit 2003, trashëgimtarët e A.H. (të cilët pas pjesëtimit vullnetar, pjesët takuese nga bashkëpronësia i përfituan në ndërtesën 2-katëshe), kanë kërkuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Durrës regjistrimin e pasurisë truall dhe ndërtesë. Mbi një padi të njërit prej tyre, me vendimin nr. 924, datë 23.06.2003, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur detyrimin e ZVRPP-së, Durrës për të regjistruar aktin e pjesëtimit vullnetar të vitit 1969 dhe lëshimin e vërtetimeve të reja të pronësisë, sipas pjesëve të përcaktuara në të. Mbi bazën e urdhrin të ekzekutimit për këtë vendim, të lëshuar në vitin 2011, ZVRPP-ja, Durrës ka bërë regjistrimet hipotekare edhe në favor të trashëgimtarëve të gjyshit të kërkuarve Arlind dhe Endri Hoxha, një nga të cilët ishte dhe babai i tyre, për pasurinë apartament dhe truallin nën të me sipërfaqe 32,54 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja tjetër e truallit përtej ndërtesës nuk është regjistruar edhe pas ankesave të paraqitura në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila, në përgjigjet e muajit mars dhe prill të vitit 2012, ka informuar se regjistrimi i kësaj sipërfaqeje nuk mund të bëhet në kushtet kur në skicën shoqëruese të aktit të pjesëtimit vullnetar të vitit 1969 nuk përcaktohet qartë sipërfaqja 1310 m<sup>2</sup>, përveçse sipërfaqja e pretenduar rezultonte të mbivendosej me pasurinë e regjistruar në favor të Komunitetit Mysliman, në bazë të vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës.

4. Në datën 30.05.2012 trashëgimlënësi i kërkuarve i është drejtuar gjykatës me padi, në objektin e së cilës ka kërkuar: (i) anulimin e vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës; (ii) detyrimin e të paditurit, Komunitetit Mysliman, të njohë trashëgimtarët e A.H. pronarë të pasurisë truall me sipërfaqe 1034 m<sup>2</sup>, për të cilën kishte mbivendosje të pronave; (iii) detyrimin e ZVRPP-së, Durrës të regjistrojë truallin me sipërfaqe 1310 m<sup>2</sup> në emër të trashëgimtarëve të A.H. Në

përfundim të gjyqimit, me vendimin nr. (11-2013-661) 350, datë 07.02.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se paditësi nuk legjitimohej për kundërshtimin e vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës, për sa kohë nuk ka kundërshtuar brenda afatit ligjor vendimin nr. 240/2007 të AKKP-së, përveçse, në mungesë të një kërkimi në padi, ajo nuk mund të shqyrtonte kryesisht pavlefshmërinë e këtij vendimi, si dhe se pretendimin e pronësisë paditësi e ka mbështetur vetëm mbi një vendim gjyqësor për vërtetim fakti, ndërkohë që i padituri, Komuniteti Mysliman, dispononte dokumentacion të saktë origjinal që vërtetonte pronësinë e tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim trashëgimlënësi i kërkuesve.

5. Në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit kërkuesit janë thirrur me zëvendësim në vend të trashëgimlënësit të tyre, për shkak se ai kishte ndërruar jetë. Me vendimin nr.204/10-2015-506, datë 04.03.2015, Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se paditësi nuk ka provuar interesin e ligjshëm për kundërshtimin e vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), mbi të njëjtat argumente, si dhe gjykata e shkallës së parë. Për rekursin e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-3019, datë 13.07.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

6. Në datën 12.02.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar në datën 22.02.2024.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi kërkuesit kanë ngritur pretendime pronësie nëpërmjet padisë së rivendikimit, sipas nenit 296 të Kodit Civil (KC), por gjykatat e kanë devijuar gjykimin, duke e trajtuar atë si çështje për “njohje dhe kthim prone”. Kjo padi shoqërohet edhe me shfuqizimin e aktit cenes, ndërkohë që gjykatat kanë ndryshuar shkakun ligjor të saj, duke e trajtuar atë si padi ndaj AKKP-së për njohjen

dhe kthimin e pronës, sipas ligjit nr. 9235/2004. Gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim dhe vlerësim pretendimet e pronësisë së kërkuesve, të cilët, në aspektin kushtetues, kanë të drejtë që çështja e tyre të shqyrtohet dhe gjykatat të shprehen për bazueshmërinë ose jo në themel të pretendimeve të tyre për pronën.

7.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi arsyetimi i gjykatave është kontradiktor, i paplotë dhe nuk u jep përgjigje pretendimeve të kërkuesve për të drejtën e pronës. Gjykatat nuk kanë vlerësuar provat, ndërsa eksperti i caktuar nga vetë gjykata ka konfirmuar se në bazë të dokumenteve ka mbivendosje të pronave dhe se të dyja palët në proces janë pronare dhe fqinje. Ato nuk janë shprehur as për dokumentacionin arkivor të vitit 1932, që konfirmon transaksionin dhe regjistrimin e pronësisë së trashëgimlënësit të kërkuesve, ndërkohë që kanë vlerësuar si provë për pronësinë e Komunitetit Mysliman dekretin nr. 279, datë 07.02.1947, pa marrë parasysh se ky dokument përbën provë edhe për pronësinë e kërkuesve, për sa kohë trashëgimlënësi i tyre A.H. paraqitet si kufitar në veri të truallit të shtetëzuar, Vakëfit Mysliman. Gjykatat kanë anashkalluar edhe faktin se trashëgimtarët e A.H. e kanë poseduar dhe vazhdojnë ta posedojnë pronën si përpara, ashtu edhe pas viteve '90, pa ndryshime. Arsyetimi i munguar i gjykatave të të gjitha shkallëve për origjinën dhe mbivendosjen e pronave përbën një mangësi thelbësore të procesit dhe i bën të cenueshme vendimet e tyre.

8. *Subjekti i interesuar, Komuniteti Mysliman*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

- 8.1. Kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit, të parashikuar nga neni 50, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.
- 8.2. Pretendimi për cenimin *e së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi gjykatat kanë zbatuar drejt ligjin procedural e material, duke mos i legjitimuar kërkuesit në ngritjen e padisë, për shkak se ata kanë ezauruar të drejtën për t’iu drejtuar organit kompetent, AKKP-së, i cili, me vendimin nr. 240/2017 ka vendosur të mos u njohë pronësinë, vendim ky që ka marrë formë të prerë dhe nuk është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, duke marrë statusin e “gjësë së gjykuar”, prandaj pranimi i çdo argumenti ndryshe do të cenonte parimin e sigurisë juridike.

- 8.3. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor. Në vendim janë parashtruar saktë pretendimet e palëve, vendimet e gjykatave më të ulëta dhe pasi Kolegji Civil ka bërë vlerësimin e tij ka arsyetuar vendimmarrjen. Rekursi i kërkuarve nuk ka paraqitur shkaqet e kërkuara nga dispozitat ligjore në fuqi.
- 8.4. Kërkuarët nuk kanë provuar cenimin e ndonjë të drejte nga palët e paditura në proces, për aq kohë sa Komuniteti Mysliman është pronar i truallit me vendimin nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës, të regjistruar në ZVRPP-në, Durrës, sipas vërtetimit të pronësisë nr. 40, datë 18.06.2008. Kërkuarët nuk kanë paraqitur dokumente pronësie për truallin e pretenduar ose dokumente për fitimin e pronësisë në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Akt-njoftunia e Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës e vitit 1955 është vendim gjyqësor për vërtetim fakti, vendim i cili është marrë pas shtetëzimit të pronës, në vitin 1947, Komunitetit Mysliman. Po kështu, edhe regjistrimi hipotekar i vitit 1969 për aktin e pjesëtimit vullnetar tregon për pjesëtimin e ndërtesave, por jo të truallit, i cili nuk mund të pjesëtohej në mungesë të origjinës së fitimit të pronësisë. Kërkuarët kanë pranuar në gjykim se nuk e posedojnë pronën dhe se atë e posedon Komuniteti Mysliman, i cili ka lidhur kontratë për realizimin e një ndërtimi që është drejt përfundimit. Konkluzionet e aktit të ekspertimit gjyqësor për mbivendosje të pronave janë të pabazuara teknikisht, pasi vetë eksperti sqaron se nuk është bazuar në dokumente hartografike, por vetëm në pretendimet e kërkuarve.
9. *Subjektet e interesuara, ASHK-ja dhe ATP-ja*, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitetin e kërkuarve

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të Vendim i Gjykatës Kushtetuese

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, kërkuessit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhje kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuessit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhje, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr.8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata konstaton se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuessit është ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që mban datën 13.07.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.02.2024. Me shkresën nr. 6130/1 prot., datë 22.11.2023, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 13.11.2023, që është edhe momenti kur palët mund ta dispononin këtë vendim. Për rrjedhje, duke konsideruar datën 13.11.2023 si data nga e cila fillon të llogaritet afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vlerëson se ai është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj prapësimi i subjektit të interesuar, Komunitetit Mysliman, për mungesën e legjitimitit *ratione temporis* të kërkuessve, është i pabazuar.

15. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të

vendimit gjyqësor, pretendime të cilat, për nga natyra e tyre, janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Megjithatë, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe thelbin e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon që t'i vlerësojë ato në drejtim të bazueshmërisë në themel, duke i analizuar të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

## *B. Për themelin e pretendimeve*

### *B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

16. Kërkuesit kanë pretenduar se edhe pse përpara gjykatave janë ngritur pretendime pronësie, ato e kanë devijuar gjykimin, duke e trajtuar si një çështje për “njohje dhe kthim prone”. Sipas tyre, padia e paraqitur në gjykata është padi rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, e cila është shoqëruar edhe me kërkimin e shfuqizimit të aktit cenes të së drejtës, ndërkohë që gjykatat kanë ndryshuar shkakun ligjor të saj, duke e trajtuar si padi ndaj AKKP-së për njohje dhe kthim prone sipas ligjit nr. 9235/2004. Kjo, sipas kërkuesve, ka sjellë që pretendimet për të drejtën e pronës të mos merren në shqyrtim, duke mos marrë përgjigje përfundimtare për bazueshmërinë ose jo të tyre. Po sipas kërkuesve, arsytimi i gjykatave është kontradiktor, i paplotë dhe nuk u jep përgjigje pretendimeve të tyre për të drejtën e pronës, ndërkohë që gjykatat nuk kanë vlerësuar provat, ndërsa eksperti i caktuar nga vetë gjykata ka konfirmuar se në bazë të dokumenteve ka mbivendosje të pronave dhe se të dyja palët në proces janë pronare dhe fqinje. Sipas tyre, gjykatat nuk janë shprehur as për dokumentacionin arkivor të vitit 1932, që konfirmon transaksionin dhe regjistrimin e pronësisë së trashëgimlënësit të kërkuesve, ndërkohë që kanë vlerësuar si provë për pronësinë e Komunitetit Mysliman dekretin nr. 279, datë 07.02.1947, pa marrë parasysh se ky dokument përbën provë edhe për pronësinë e kërkuesve, për sa kohë trashëgimlënësi i tyre A.H. paraqitet si kufitar në veri të truallit të shtetëzuar, Vakëfit Mysliman. Sipas kërkuesve, gjykatat kanë anashkaluar edhe faktin se trashëgimtarët e A.H. e kanë poseduar dhe vazhdojnë ta posedojnë pronën si përpara, ashtu edhe pas viteve ‘90, pa ndryshime.

17. Subjekti i interesuar, Komuniteti Mysliman, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë zbatuar drejt ligjin procedural dhe material, duke mos i legjitimuar ata në ngritjen e padisë, për shkak se ata e kanë ezauruar të drejtën për t’iu drejtuar organit kompetent, AKKP-së, i cili, me vendimin nr. 240/2017 ka vendosur të mos u njohë pronësinë, vendim ky që ka marrë formë të prerë dhe nuk është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, duke marrë statusin e “gjësë së gjykuar”. Për rrjedhojë, pranimi i çdo argumenti ndryshe do të



cenonte parimin e sigurisë juridike. Sipas këtij subjekti, kërkuesit nuk kanë provuar cenimin e ndonjë të drejte nga palët e paditura në procesin gjyqësor, për aq kohë sa Komiteti Mysliman është pronar i trullit me vendimin nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës. Po sipas këtij subjekti, vendimet gjyqësore janë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe vendimi i Gjykatës së Lartë ka parashtruar saktë pretendimet e palëve, vendimet e gjykatave më të ulëta dhe pasi Kolegji Civil ka bërë vlerësimin e tij, ka arsyetuar këtë vendimmarrje, ndërkohë rekursi i kërkuesve nuk përmbante shkaqe nga ato që kërkojnë dispozitat ligjore në fuqi.

18. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, zbatimi i këtij parimi vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. Ndërsa ka pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë, Gjykata ka theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë*

23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kurse për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në fazën e shqyrtimit paraprak të rekurseve, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 22, datë 06.06.2011; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*

21. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuar në ankimin kushtetues individual ka të bëjë, në thelb, me faktin se gjykatat e zakonshme kanë rrëzuar padinë e tyre të pronësisë pa e shqyrtuar atë themel, pra pa i dhënë përgjigje bazueshmërisë ose jo të pretendimeve të tyre, duke arsyetuar se atyre u mungon interesi i ligjshëm ndaj nuk legjitimohen në ngritjen e saj për sa kohë nuk kanë kundërshtuar gjyqësisht dhe brenda afatit ligjor një vendim të AKKP-së, me të cilin është disponuar për mosnjohjen e së drejtës së pronësisë. Ndaj, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, Gjykata vlerëson të analizojë nëse interpretimi i gjykatave të zakonshme për mospasjen interes të ligjshëm të kërkuar në ngritjen e padisë përmbush standardet kushtetuese në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Me fjalë të tjera, Gjykata do të verifikojë nëse arsyetimi i gjykatave të zakonshme përmban gabime faktike ose ligjore, të cilat nuk janë objektivist të justifikueshme dhe të arsyeshme.

22. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson të theksojë se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur. Sipas nenit 12

të KPC-së, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Në këtë kuptim, është pala që vë në lëvizje gjykatën që ka detyrimin të provojë pretendimet e saj dhe të paraqesë provat për këtë qëllim (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 38, datë 30.06.2014; nr. 5, datë 20.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar fakteve me natyrë kushtetuese të konstatuara gjatë këtij gjykimi, Gjykata vëren se trashëgimlënësi i kërkuesit fillimisht i është drejtuar AKKP-së për njohjen dhe kthimin e pronës sipas ligjit nr. 9235/2004 dhe me vendimin nr. 240/2007 ajo ka vendosur përfundimisht mosnjohjen e pronës, ndërsa ka konstatuar se ishte disponuar më parë nga KKKP-ja, Durrës për njohjen e kthimin e saj në favor të një subjekti tjetër, Komunitetit Mysliman. Pas kësaj, trashëgimlënësi i kërkuesit ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe me padinë e paraqitur ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës të dhënë në favor të Komunitetit Mysliman, si dhe detyrimin e këtij të fundit për të njohur pronarë trashëgimtarët e A.H. për pasurinë truall me sipërfaqe 1034 m<sup>2</sup>. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se: (i) paditësi nuk legjitimohej për kundërshtimin e vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës, për sa kohë ai dhe trashëgimtarët e tjerë të A.H. nuk kanë ushtruar, brenda afatit ligjor, të drejtën e ankimit, sipas nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, kundër vendimit nr. 240/2007 të AKKP-së, me të cilin është disponuar për mosnjohjen e së drejtës së pronës; (ii) në mungesë të një kërkimi në padi, ajo nuk mund të shqyrtonte kryesisht pavlefshmërinë e vendimit nr. 240/2007 të AKKP-së; (iii) pretendimin e pronësisë paditësi e mbështetet vetëm mbi një vendim gjyqësor për vërtetim fakti të vitit 1955, ndërkohë që nuk kishte një akt shpronësimi, i cili të vërtetonte marrjen e pronës nga shteti pas datës 29.11.1944 dhe, për më tepër, i padituri, Komuniteti Mysliman, dispononte dokumentacion origjinal për vërtetimin e pronësinë, dokumentacion ky që është më i saktë në aspektin ligjor.

24. Mbi ankimin e paditësit (trashëgimlënësi i kërkuesve), gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë si ajo se pala paditëse nuk ka arritur të provonte interesin e ligjshëm, në kuptim të nenit 32 të KPC-së, për kundërshtimin e vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës, për sa kohë nuk ka kundërshtuar gjyqësisht, sipas ligjit nr. 9235/2004, vendimin nr. 240/2007 të AKKP-së, i cili ka rrëzuar kërkesën e trashëgimtarëve të A.H. për njohjen dhe kthimin e pronës, vendim ky i cili ka marrë formë të prerë, përveçse as në objektin e padisë nuk ka kërkim për kundërshtimin e këtij vendimi. Sipas asaj gjykate, pala paditëse nuk mund të pretendojë ndaj të tretëve, përfshirë Komunitetin Mysliman, të drejta reale në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, pa goditur më parë vendimin nr. 240/2007 të AKKP-

së, që nuk i ka njohur asaj të drejtën e pronësisë. Ndërkohë, ajo gjykatë nuk ka vlerësuar themelin e pretendimeve në padi në lidhje me të drejtën e pronës.

25. Për rekursin e kërkesve, të cilët janë bërë pjesë e procesit gjyqësor në gjykimin e çështjes në apel për shkak se trashëgimlënësi i tyre ka ndërruar jetë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

26. Nga sa më lart, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga trashëgimlënësi i kërkesve me një padi për njohjen e pronësisë, në kuadër të së cilës është kërkuar edhe anulimi i vendimit nr. 205/1/1997 të KKKP-së, Durrës, në bazë të të cilit prona mbahej nga i padituri (subjekti i interesuar), Komuniteti Mysliman. Pavarësisht natyrës dhe llojit të kësaj padie, gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar atë, duke parashtruar argumente të natyrës procedurale, por edhe substanciale. Ndërkohë, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konsideruar vetëm argumentet e natyrës procedurale. Kurse Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkesve, praktikisht ka vlerësuar të ligjshëm vendimin e gjykatës së apelit.

27. Gjykata vëren se rregullat për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile, ku bën pjesë edhe ajo për të drejtën reale të pronësisë, përcaktohen nga KPC-ja. Sipas kësaj të fundit, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile (*neni 36*), pra ato mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me të drejta subjektive që burojnë nga e drejta private, ndër to edhe e drejta reale e pronësisë. Ky kod ngarkon gjykatën me detyrimin për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor (*neni 14*) dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, të detyrueshme për t'u zbatuar prej saj (*neni 16*).

28. Në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës, Gjykata është shprehur se ai lindi si një nevojë për të vendosur drejtësinë sociale për arsye se individët ishin zhveshur nga prona në përputhje me legjislacionin e kohës, por në kundërshtim me elementet bazë të së drejtës të shteteve demokratike, në të cilat e drejta e pronës private njihet dhe mbrohet nga rendi juridik dhe se, në këto kushte, individëve të ndryshëm, të cilët ishin privuar nga e drejta e pronës gjatë regjimeve totalitare, u lindi e drejta që të kërkonin të viheshin në të njëjtat pozita juridike në lidhje me pronën, siç kishin qenë përpara shtetëzimit. Sipas saj, kërkesa e një personi përpara organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave synon njohjen e së drejtës së pronës për një send të caktuar, e cila është një e drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të KPC-së, ndërsa ajo rregullohet nga KC-ja, duke qenë jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike.

Gjykata ka theksuar se vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, ndër vite, nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por, përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm, kërkon të drejtën e pronës, duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte dhe se shqyrtimi i saj mund të bëhet vetëm nga gjykata e zakonshme, në përputhje me KC-në (*shih vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata, po ashtu, vëren se për sa i përket ligjit nr. 9235/2004, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, ka bërë interpretimin unifikues/njësues të tij, interpretim ky i detyrueshëm jo vetëm për gjykatat më të ulëta, por edhe për vetë atë. Konkretisht, në vendimin unifikues nr. 2, datë 21.01.2011, Gjykata Lartë ka arritur në përfundimin se në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, subjektet e shpronësuar nuk kanë detyrim për t'iu drejtuar rrugës përkatëse administrative nëse për të njëjtën pronë, ish-KKKP-ja ose AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen e kthimin e saj një subjekti tjetër të shpronësuar, raste në të cilat çështja i përket juridiksionit gjyqësor. Edhe në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, Gjykata Lartë, ndërsa ka rikonfirmuar qëndrimin e saj si më lart, ka arritur në përfundimin se në gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimit të KKKP-së ose AKKP-së, kemi të bëjmë me të drejta subjektive dhe vendimet e tyre nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte të mirëfillta administrative, se subjekti kërkues në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e KKKP-së ose AKKP-së dhe kërkon të drejtën e pronës, duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtës së tij të pronësisë, ndërkohë që gjykata zhvillon një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë, duke ndryshuar ose shfuqizuar vendimin e KKKP-së ose AKKP-së, si dhe duke zgjidhur në themel këtë konflikt pronësie.

30. Për sa i përket së drejtës së ankimit në gjykatë për vendimet e AKKP-së, Gjykata vëren se ligji nr. 9235/2004, sipas përmbajtjes së tij në momentin kur AKKP-ja ka disponuar me vendimin nr. 240/2007, për mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për trashëgimlënësin e kërkuesve, ndërsa ka parashikuar një të drejtë të tillë për subjektet e shpronësuar, nuk ka përcaktuar afate për ushtrimin e saj. Një afat i tillë në këtë ligj, konkretisht 30 ditë, është parashikuar në nenin 18 të tij vetëm pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, dispozitë e cila duket se është zbatuar në rastin konkret nga gjykatat e zakonshme. Kjo dispozitë e ligjit i është nënshtruar kontrollit kushtetues dhe Gjykata është shprehur se ai rregullon çështjen e aksesit në gjykatë dhe afatin ligjor për të kundërshtuar vendimet e AKKP-së. Gjykata ka vlerësuar se gjykata që zgjidh çështjen ka të gjithë hapësirën e nevojshme që t'u referohet normave ligjore në fuqi për zgjidhjen

e saj, më konkretisht dispozitave përkatëse të KPC-së, dhe se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës (shih vendimin nr. 5, datë 05.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

31. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja e parashtruar përpara gjykatave të zakonshme lidhet me të drejtën e pronësisë, ndërsa padia e kërkuarve për njohjen e kësaj të drejte është rrëzuar përfundimisht nga gjykata e apelit me argumente të natyrës procedurale, pa e shqyrtuar atë në themel, zgjidhje e cila është vlerësuar e pacenueshme nga Gjykata e Lartë. Ato gjykata kanë anashkaluar faktin se prona objekt mosmarrëveshjeje i është njohur dhe kthyer më parë Komunitetit Mysliman, duke qenë ky shkak i asaj vendimmarrjeje të AKKP-së në disfavor të kërkuarve (trashëgimlënësit të tyre), ndërkohë që pikërisht për këtë shkak mosmarrëveshja mes palëve për të drejtën e pronësisë është bërë pjesë e juridiksionit gjyqësor. Në situatën konkrete të rastit, kërkuarët (trashëgimlënësi i tyre) as kanë pasur detyrimin për të ndjekur rrugën administrative për njohjen dhe kthimin e pronës, sikundër as vendimi i AKKP-së për kërkesën e tyre nuk mund çonte në humbjen e së drejtës së pronësisë dhe as të kushtëzonte ushtrimin nga ata të së drejtës së padisë për kërkimin e pronës. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, me jurisprudencën kushtetuese dhe atë unifikuese/njësuere të Gjykatës së Lartë, ata i janë drejtuar rrugës gjyqësore për të kërkuar të drejtën e pronësisë, duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte, porse gjykatat e zakonshme nuk kanë zhvilluar një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë, duke mos e zgjidhur në themel konfliktin e pronësisë mes palëve. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykatat e zakonshme duket se faktin e mosnjohjes së të drejtës së pronës nga AKKP-ja, për shkak se ishte disponuar më parë nga KKKP-ja, Durrës, për njohjen e kthimin e saj në favor të një subjekti tjetër (të paditurit në proces), e kanë interpretuar se mund të passjellë humbjen e kësaj të drejte për kërkuarët. Po kështu, ato, duket se faktin e moskundërshtimit në objektin e padisë nga kërkuarët të atij vendimi të AKKP-së, e kanë interpretuar si arsye të mjaftueshme për rrëzimin e padisë pa e shqyrtuar atë në themel. Kjo mënyrë e interpretimit të këtyre fakteve, në vlerësim të Gjykatës, duket e paarsyeshme në këndvështrimin kushtetues dhe në pikëpamje të së drejtës, duke pasur në konsideratë se pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër (me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në KC), ose kur hiqet dorë prej saj, si dhe se rrëzimi i padisë nga gjykata nënkupton pathemelësinë e saj, pas zhvillimit të një procesi gjyqësor në lidhje me mosmarrëveshjen e paraqitur asaj për zgjidhje.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se gjetjet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, sa u përket fakteve dhe interpretimit të ligjit, nuk janë objektivisht të justifikueshme dhe të

arsyeshme, për sa kohë nuk marrin në konsideratë as qëndrimet unifikuese/njësuese, ndaj vendimet e tyre nuk përmbushin funksionin e një vendimi të drejtë nga pikëpamja e arsyetimit. Po kështu, duke mos e shqyrtuar padinë e kërkesve në themel, pra duke mos u dhënë përgjigje për pretendimet në lidhje me të drejtën substanciale të pronës, ato gjykata u kanë cenuar atyre të drejtën e aksesit në gjykatë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkesve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i bazuar.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkesve janë pjesërisht të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet pranuar pjesërisht, vetëm sa i përket vendimit të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
  2. Shfuqizimi i vendimeve nr. 204/10-2015-506, datë 04.03.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2023-3019, datë 13.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
  3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 29.10.2024**

**Shpallur më 04.12.2024**